



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

**NR. 9 DATË 10.05.2013**

**PËR MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE, PËR NDËRTIMIN E  
RESORTIT TURISTIK "OMNIX ALBANIA", NË GJIRIN E LALËZIT, KOMUNA ISHËM,  
QARKU DURRËS**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 70/8 dhe nenit 70/11 të Ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011, "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", Këshilli Kombëtar i Territorit

**V E N D O S I :**

1. Të miratohet leja zhvillimore komplekse për ndërtimin e resortit turistik "Omnix Albania", me investitor "Omnix Albania" sh.p.k, në Gjirin e Lalëzit, komuna Ishëm, qarku Durrës, me vërejtjet si më poshtë:
  - Zona e parashikuar si vendparkim në planimetrinë e përgjithshme, përkatësisht në zonën kadastrale 1522, me nr. Pasurie 152/9, të shfrytëzohet si ambient rekreacioni.
  - Zona e parashikuar si vendparkim në planimetrinë e përgjithshme, përkatësisht në pjesën jugore të saj, të shfrytëzohet si ambient rekreacioni.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**


**SALI BERISHA**

**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**



**SOKOL OLLDASHI**

**MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**



**SEKRETARE E KKT**

**KREUZA LEKA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

